



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 479/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e Jeton Eminit, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia e Ashkalinve për Integrim (PAI), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, lidhur me publikimin e rezultateve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar apeli Anr.479/2019 e datës 08.11.2019, e paraqitur nga Jeton Emini, kandidat për deputet nga subjekti politik Partia e Ashkalinve për Integrim (PAI), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar përfshirjen 116 votave të tij nga diaspora.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik PAI, Jeton Emini, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.479/2019, me të cilën pretendon se pas publikimit të rezultateve, subjekti i tij politik iu janë shënuar 3102 vota në total dhe ai si kandidat me numër rendor 4 sipas rezultatit të KQZ-së posedon 621 vota. Paraqitësi i apelit pretendon se apeli i tij ka të bëjë me çështjen që në formularët e publikuar nga KQZ-ja, nuk janë të përfshira të gjitha votat me postë nga diaspora, në totalin e përgjithshëm të subjektit, me të cilën ka ndryshuar renditjen e kandidatëve. Në vazhdim pretendon se QNR-ja në fazën e parë të procesit të numërimit të votave të diasporës ka dhënë si rezultat 13241 vota prej tyre subjekti politik PAI i janë publikuar 116 vota nga mediat dhe tabela e rezultateve në QNR. Pas vendimit të Gjykatës Supreme për të numëruar pjesën tjetër të votave të diasporës, paraqitësi i apelit pretendon se QNR-ja numëron 4551 vota me të cilën subjekti i tij PAI merr 84 vota me të cilën ishin publike nga mediat dhe tabela e numërimit në QNR. Paraqitësi i apelit pretendon se si në fazën e parë ashtu edhe në fazën e dytë me të cilën është dëshmuar edhe nga vëzhguesit e tyre me të cilën kanë qenë prezent dhe PAI, në total sipas tij ka 200 vota, ndërsa në rezultatet finale të KQZ-së, janë përfshirë 84 vota, të procesuara në fazën e dytë dhe iu mungojnë procesimi i 116 votave nga diaspora. Paraqitësi i apelit potencon se nëse iu shtohen këto vota PAI, në total si subjekt do të ketë 3218 vota, me të cilën sipas tij ndryshon edhe rezultatit dhe renditjen brenda listës së kandidatëve PAI. Paraqitësi i apelit, ia ka bashkangjitur si dëshmi apelit, kopjen e tabelës së publikimit të rezultateve nga QNR.

Në përgjigjen në apel e pranuar nga KQZ, theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e Kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të te gjeturave përgatit raportin dhe QNR

në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në, që vendvotimet që kanë probleme të kësaj natyre të Rinumërohen. Pra asnjë Formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti do të nënshtrohet Auditimit në QNR. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se pala ankuese nuk ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike dhe nuk ka prezentuar mjaftueshëm prova për rastin konkret.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

Paneli, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase paraqitësi i apelit me apelin e tij kërkon që të shqyrtohet dhe procesohet rezultati i saktë dhe t'i përfshihen 116 vota, të munguara nga rezultati përfundimtar, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ, i njëjti posedon 621 vota, ndërsa sipas paraqitësit të apelit subjektivit të tyre i mungojnë edhe 116 vota të diasporës.

Mirëpo nga pretendimet ankimore me asnjë provë bindëse nuk është dëshmuar se në cilët vendvotime të diasporës iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon ankuesi, prandaj lidhur me këtë çështje Paneli, apelin e paraqitësit e konsideron si të përgjithshme dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, Paneli, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase paraqitësi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi paraqitësin e apelit, po ashtu nuk ka specifikuar asnjë VV, me të cilën dyshon se i mungojnë 116 votat nga diaspora, nga procesimi i votave nga diaspora dhe nuk ka bashkangjitur asnjë provë shkresore që do ta argumentonin pretendimin e tij.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë apelin e apeluesit e refuzon.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.479/2019 më datën 09.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.